VENDIM
Nr.504, datë 18.10.1993

PËR EMETIMIN E OBLIGACIONEVE SHTETËRORE PËR KOMPENSIMIN E ISH-PPRONARËVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIK

Në zbatim të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", ligjit nr.7699, datë 21.4.1993 "Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore", dhe ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", ndryshuar me ligjin nr.7660, datë 14.1.1993 dhe ligjit nr.7719, datë 8.6.1993, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Titujt që do të shërbejnë për kompensimin e ish-pronarëve, do të quhen obligacione shtetërore. Në to do të pasqyrohet shkaku i emetimit, vlera nominale, garancia për t'u rimbursuar pas periudhës së nënshkrimit dhe e drejta e poseduesit për t'i shkëmbyer (ose shitur) lirisht vetëm në procesin e privatizimit.

2. Këto obligacione, që do të emetohen nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, do të shërbejnë për kompensimin e ish-pronave në qytet e në fshat dhe të pasurisë së konfiskuar të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë.

3. Forma e obligacionit të jetë sipas standardit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Prerja do të bëhet sipas kësaj strukture:

2% në prerje	5.000 lekë
48% në prerje	10.000 lekë
0% në prerje	50.000 lekë
20% në prerje	100.000 lekë

Sasia totale në vlerë e partisë së parë të jetë 20 miliardë lekë.

5. Fillimi i procesit të shpërndarjes dhe sasia totale e vlerës së obligacioneve shtetërore që do të emetohet, të fillojë pas përcaktimit të përafërt të vlerës së pasurisë shtetërore që do të shitet dhe asaj që do të kompensohet.

6. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Privatizimit që, në bashkëpunim me ministritë sektoriale, të bëjë vlerësimin e pasurisë shtetërore që do të shitet dhe të paraqesë në Këshillin e Ministrave studimin përkatës brenda datës 30.11.1993.

Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Komiteti Shtetëror i kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve dhe Komiteti i ish-Përndjekurve Politikë të bëjnë vlerësimin e pronave që do të kompensohen, dhe të paraqesin në Këshillin e Ministrave studimin përkatës brenda datës 30.11.1993.

7. Shpërndarja e obligacioneve do të bëhet nga degët e thesarit në rrethe, në bashkëpunim me ato të Bankës Kombëtare Tregtare.

8. Shpenzimet e emetimit për rreth 200 mijë USD dhe që përballohen nga buxheti i shtetit, do të shlyhen nëpërmjet shitjes së obligacioneve me një çmim të barabartë me 0.1 për qind të vlerës nnominale të tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KëSHILLIT Të MINISTRAVE
Aleksandër Meksi